



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 3887/prot

Koplik më: 28 / 12 / 2025

V E N D I M

Nr 62 datë 24 / 12 / 2025

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 24.12.2025, mbeshtetur në aktin normativ nr 3 datë 15.03.2020 neni 5, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.7/a, të Ligjit 94/2022 " PËR TITUJT E NDERIT DHE TITUJT VENDORË TË NDERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" neni 9 pika 1.

VKM Nr.861 datë 10.12.2014 Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë.

VENDOSI

T'i akordojë titullin "Qytetar Nderi "Z. **Armando Broja** me motivacionin:

"Për punën, përkushtimin e profesionalizmin e tij në fushën e sportit e në veçanti atij të futbollit duke u shpallur edhe finalist në Kampionatin European të Futbollit 2024 me fanellën e Ekipit tonë Kombëtarë të Futbollit për të na bërë krenarë gjithë malësorët e mbarëshqiptarët kudo që janë duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe e më gjërë".

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Brendshme.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 24.12.2025

Vota Pro 25

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 29.12.2025







REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE

Nr. 9887.prot

Koplik më: 23/12/2025

Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe
Propozim për dhënie titulli “ Qytetarë Nderi “ i Bashkisë Malësi e
Madhe z. Armanda Broja



Armando Broja ka lindur me 10 Shtatorë 2001 në Londër, Angli. Ka filluar që në moshë 7 vjeçare të merret me sportin e bukur të futbollit e falë talentit të tij ka qënë pjesë e Akademisë së Çelsit dhe më pas në moshë 17 vjeçare me ekipin e pare të kësaj skuadre me emër në futbollin botërorë. Ka luajtur edhe me ekip të tjera ku sot është tek ekipi I

Adresa:Koplik-Qender

tel:021122650/2651

e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com



Burnleyt. Por ajo që e bëri mjaft të njohur për atdhetarinë e kontributin e tij në futboll ishte veshja e fanellës Kombëtare Shqiptare të Futbollit që nga viti 2022 duke qënë një ndër sulmuesit më të mire shqiptarë. Mori pjesë me ekipin Kombëtarë në Finalet Europiane të 2024.

Armando Broja vjen nga një familje me tradita të denja malësore e atdhetare nga Kamica por me prejardhje nga fshati Brojë i Kelmendit, Malësi e Madhe.

Për gjitha sa thamë më lartë i propozohet Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe ti jepet titulli " Qytetarë Nderi " i Bashkisë Malësi e Madhe me

motivacion:

"Për punën, përkushtimin e profesionalizmin e tij në fushën e sportit e në veçanti atij të futbollit duke u shpallur edhe finalist në Kampionatin Europian të Futbollit 2024 me fanellën e Ekipit tonë Kombëtarë të Futbollit për të na bërë krenarë gjithë malësorët e mbarëshqiptarët kudo që janë duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe e më gjërë".

KRYETAR BASHKIE

TONIN MARINAJ

